



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**  
**V E N D I M**

Nr. 68/1 dt.30.04.1996

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.30.04.1996, mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Komisioni i Kthimit të Pronave, bazuar në vendimin Nr.396, dt.22.01.1996 të paraqitur nga Komisioni Juridik për miratim,

**VENDOSI**

1. Në bazë të ligjit Nr.7698, dt.15.04.1993 Bajram Driza (trashëgimtarët e tij) të kompesohen me truall të lirë shtetërorë me 5.000 m<sup>2</sup> sipas gen-planit të hartuar nga Kadastra Urbane, që ndodhet në rrugën nacionale Tiranë - Durrës, përballë firmës Gintash ose në vend tjetër, zona të miratuara në K.RR.T. si shesh ndërtimi. Kjo sipërfaqe i kompesohet në bazë të ligjit të lart përmendur, njëkohësisht i heq të drejtën mbi pronësinë e mëparëshme që disponojnë sipas vendimit, të Komisionit të Kthimit të Pronave me Nr.396, dt.22.01.1996.  
Në zbatim të ligjit dhe këtij vendimi ngarkohen Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit të Pronave si dhe Kadastra Urbane të bëjë veprimet e duhura.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**